



**Instituti Kosovar për Hulumtime dhe Zhvillime të Politikave**  
**Seria e analizave politike : Punimi # 2**

**SHËRBIMET NË HIJE TË INTELIGJENCËS NË KOSOVË: SHPËRBËRJE,  
SHKRIRJE APO INTEGRIM?**

**Prishtinë, maj 2006**

Ky projekt është përkrahur nga Freedom House dhe USAID.

Përgatitur nga: Ilir Dugolli dhe Lulzim Peci

Redaktoi: Leon Malazogu

Copyright © 2006 KIPRED. Të gjitha të drejtat e riprodhimit janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtitëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar, etj. pa lejen me shkrim të botuesit. Luteni të kontaktoni: [info@kipred.net](mailto:info@kipred.net) ose +381 38 555 887.

Botuar nga:



KIPRED (Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave)  
Kodra e Diellit, Rruga 3, Lam. 39  
Prishtinë, Kosovë (UNMIK)  
Tel. dhe fax: +381 38 555 887

[www.kipred.net](http://www.kipred.net)

## **PËRMBAJTJA**

<b>VËRSHIMI NGA SHËRBIMET PARTIAKE .....</b>	<b>5</b>
<b>SHPËRBËRJE APO LEGALIZIM? .....</b>	<b>7</b>
<b>NJË SHËRBIM I KOSOVËS .....</b>	<b>9</b>
Sfidat .....	9
1. Politizimi .....	9
2. Marrëdhëniet ndër-institucionale .....	10
3. Një kornizë ligjore adekuate dhe e zbatueshme .....	10
Mundësia e fillimit nga zeroja .....	11
<b>PARIMET E NDËRTIMIT TË SHËRBIMIT TË ARDHSHËM TË</b>	
<b>INTELIGJENCËS NË KOSOVË .....</b>	<b>11</b>
Krijimi i bazës ligjore .....	11
Kufizimi i përgjegjësive .....	12
Hartimi i mekanizmave të llogaridhënies .....	12
<b>PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET .....</b>	<b>12</b>
<b>REFERENCAT .....</b>	<b>13</b>

## VËRSHIMI NGA SHËRBIMET PARTIAKE

Prania dhe veprimtaria e shërbimeve në hije të inteligjencës në Kosovë tanimë është bërë "fshehtësi publike". Kohëve të fundit mediat e kanë bërë këtë çështje pjesë të debateve publike, duke ia hequr kështu etiketën e tabusë. Shumë qytetarë të rëndomtë janë të vetëdijshëm për selitë e këtyre shërbimeve, me lehtësi mund të emërtojnë krerët e tyre dhe shpeshherë përfshihen në diskutime rreth këtyre shërbimeve. Madje, ka mjaft të tillë për të cilët organizatat në fjalë nuk janë fare në hije, por që presin legjitimimin. Në anën tjetër, përpjekjet e kohëve të fundit të bashkësisë ndërkombëtare për të bartur më shumë përgjegjësi në duar të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) kanë nxitur reagime të ndryshme përbrenda këtyre strukturave. Përderisa deklaratimet e zyrtarëve kanë dhënë shenja për shpërbërje, ato në të njëjtën kohë kanë shtuar ambiciet brenda strukturave në hije për të shfrytëzuar momentin dhe për t'u shndërruar në struktura legale. Përballë këtij sfondi kjo analizë shqyrton gjendjen e tanishme të shërbimeve të inteligjencës dhe ofron rekomandime për të ardhmen e këtij sektori tejet të ndjeshëm për sigurinë dhe sundimin e ligjit në Kosovë.

Një vistër e tërë e shërbimeve të inteligjencës vepron sot në Kosovë. Duke qenë e paaftë apo duke mos pasur vullnetin për t'u marrë me këto shërbime, bashkësia ndërkombëtare, në rastin më të mirë, ka toleruar praninë e tyre, apo madje, në rastin më të keq, iu ka dhënë kurajo atyre. Një raport i mëhershëm me të drejtë ka vënë në pah se prania e shërbimeve në hije "po futet nën qilim në vend se të shtrohet për diskutim" (ICG 2005: i). Edhe përkundër retorikës së kohëpaskohshme kundër shërbimeve të tilla, e gjithë periudha e pranisë së bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë shquhet për tolerimin e tyre.<sup>1</sup> Zvarritja e vendimit për të ardhmen e shërbimeve partiake deri më tani duket të ketë qenë taktika e parapëlqyer e UNMIK-ut dhe e IPVQ-ve. Por, përderisa tanimë janë duke u zhvilluar bisedat për të ardhmen politike të Kosovës, "do të jetë gjithnjë e më vështirë injorimi i çështjeve të këtilla thelbësore" (Xharra 2005). Bashkësia ndërkombëtare do të duhet të zgjedhë ndërmjet tolerimit të këtyre strukturave, shpalljes si të paligjshme apo inkorporimit të tyre. Tani është koha që administrata ndërkombëtare të vendosë se a do t'i rreket shpërbërjes, shkrierjes apo integritit të strukturave të tanishme në hije.

Cilat janë këto shërbime dhe si është e mundur që ato të veprojnë në një hapësirë që tani për tani qeveriset nga bashkësia ndërkombëtare dhe para cilave institucione

ato duhet të japin llogari për funksionimin e tyre? Dy shërbimet kryesore janë IHSOP-i<sup>2</sup> dhe SHIK-

**Përderisa tanimë janë duke u zhvilluar bisedat për të ardhmen politike të Kosovës, bashkësia ndërkombëtare duhet të zgjedhë ndërmjet tolerimit, shpalljes si të paligjshme apo inkorporimit të tyre. Tani është koha që administrata ndërkombëtare të vendosë se a do t'i rreket shpërbërjes, shkrierjes apo integritit të strukturave të tanishme në hije.**

nga konferenca javore për shtyp e UNMIK-ut të 30

blik.

u<sup>3</sup>, të lidhura me dy partitë politike kryesore, LDK-në (Lidhja Demokratike e Kosovës) dhe PDK-në (Partia Demokratike e Kosovës). Ka pohime se edhe brenda AAK-së (Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës) ka struktura të këtilla, por me më pak personel dhe pajisje. Janë mu këto struktura të inteligjencës, gjysmë-legjitime dhe gjysmë-të fshehta, të cilat janë në qendër të vëmendjes të kësaj analize të shkurtë. Shërbimet e inteligjencës së partive politike janë bërë objekt i shpeshtë i vëmendjes gazetareske si dhe burim shqetësimi për qytetarë të rëndomtë (ICG 2005: 15).<sup>4</sup> Kështu për shembull, një numër shkrimesh nëpër gazeta kohëve të fundit është marrë me IHSOP-in dhe SHIK-un, një prej të cilëve i ribotuar kohë më parë nga ICG-ja (2005: 5).

Për më tepër, përfaqësuesit e këtyre "agjencive" po bëhen gjithnjë e më të pranishëm në media, një strategji e re kjo e tyre si për të demistifikuar veten ashtu edhe për t'u paraqitur si pretendentë legjitimë për të qenë shërbimi i inteligjencës i ardhshëm në Kosovë.<sup>5</sup> Sipas anëtarëve të këtyre shërbimeve, në të kaluarën ata nuk kanë pasur "zgjidhje tjetër përveçse të qëndrojnë jashtë sistemit, pasi që Kosova nuk kishte një shërbim zyrtar të cilit do të mund t'i bashkoheshin" (Xharra 2005). Kjo qasje ka ngjallur dyshime dhe rezervime kundrejt shërbimeve në fjalë. Kadri Veseli, udhëheqës i SHIK-ut tani shpreh atë që duket të jetë mendim mbizotërues brenda agjencive të tilla kur thotë se, ata "nuk mund të vazhdojnë përherë në këtë mënyrë" (Xharra 2005). Strategjia e re e këtyre strukturave është që gjithnjë e më shumë të shihen si hiq më shumë se profesionistë të devotshëm.

Ekzistenca e IHSOP-it është e ndërlidhur me ish Ministrinë e Mbrojtjes, pjesë e qeverisë në ekzil të Kosovës, me të cilën kreu i IHSOP-it, Ramë Maraj, ka qenë në lidhje të afërt gjatë viteve nëntëdhjetë (Xharra 2005). SHIK-u buron nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) duke pasur në krye njërin nga anëtarët e Qeverisë së Përkohshme të krijuar nga Hashim Thaçi më 1999. Misioni i këtyre grupeve dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre, në rast se ekzistojnë, janë të paqarta, por besohet se aktivitetet e tyre shtrihen nga mbrojtja e afërt e zyrtarëve partiakë, mbledhja e informatave për kundërshtarët politikë apo kërcënimi i tyre. Sipas një memorandumit policor për të cilin ka raportuar një e përditshme kosovare, ndonëse nuk ka bazë ligjore për funksionimin e këtyre organizatave ato tolerohen dhe madje duket se edhe shfrytëzohen nga pjesë të ndryshme administratës ndërkombëtare në Kosovë. (ICG 2005: 15, 30). Madje, ata e shohin vetën si "legal dhe legjitim" (zyrtar i SHIK-ut 2006).

**Ndonëse nuk ka bazë ligjore për funksionimin e këtyre organizatave ato tolerohen dhe madje duket se edhe shfrytëzohen nga pjesë të ndryshme të administratës ndërkombëtare në Kosovë.**

"Ne jemi krijuar si pjesë e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, veprojmë në

<sup>3</sup> Shkurtesë për Shërbimi Informativ i Kosovës.

<sup>4</sup> B.f. në korrik 2004 organizata më parë e panjohur me emrin "Sigurimi i Atdheut" që identifikohet me FARK-un dhe pohon të ushtrorë kontroll mbi LDK-në ka lëshuar komunikata në të cilat kërcënohen "dezertorët" e partisë dhe familjet e tyre në rast të përpjekjeve për të larguar anëtarë nga radhët e partisë para zgjedhjeve të atij viti.

<sup>5</sup> P.sh. "Flet Ramë Maraj", 2005. Kosova Sot, 13 shtator, fq. 5; Hoxhaj, Bashkim. 2005. "Institucionalizimi i SHIK-ut garanton stabilitet në vend". "Epoka e Re" 2 gusht 2005, fq.9; debat në RTK, 23 nëntor 2005, me R. Maraj (kryesues i IHSOP-it), R. Qehaja (ZKM), L. Peci (KIPRED) dhe H. Gashi (ish zyrtar i ZKM-së). Për përshkrim të strategjisë së re të paraqitjes në opinion shih Xharra, Jeta. BIRN, "Kosovo's Intelligence Services Come In From The Cold". BIRN, [http://www.birn.eu.com/insight\\_15\\_6\\_eng.php](http://www.birn.eu.com/insight_15_6_eng.php) (vizituar 27 dhjetor 2005).

mënyrë publike, e kemi vulën tonë, selinë tonë, etj. Besojmë se legjitimitetin e kemi fituar përmes sakrificave tona gjatë luftës” (SHIK 2006). SHIK-u thirret në një dekret të ish Qeverisë së Përkohshme (SHIK 2006), përderisa IHSOP-i ndërlihet me strukturat e ish Qeverisë në ekzil (IHSOP 2006). Edhe përkundër kësaj, të njëjtit pranojnë se “zyrtarizimi duhet të shkoj krah për krah me zgjidhjen e çështjes së statusit” (SHIK 2006). Zyrtari nga organizata tjetër (IHSOP) shton se krijimi dhe legalizimi i shërbimit kosovar të inteligjencës duhet të bëhet “në bashkëpunim të ngushtë me bashkësinë ndërkombëtare” (IHSOP 2006).

Kjo çështje e ndjeshme dhe përgjithësisht e lënë anash, me të drejtë është ngritur në një raport të ekipit këshillëdhënës për zhvillimin e sektorit të sigurisë nga Mbretëria e Bashkuar, ku vlerësohet se strukturat në fjalë “ndikojnë dukshëm në zbehjen e besimit të sigurisë” (SSDAT 2005: 2). Prania në vend e shërbimeve të inteligjencës që nuk janë të rregulluara me ligj pasqyron dështimin e administratës ndërkombëtare dhe të KFOR-it për të vënë në jetë sundimin e ligjit. Megjithatë, ka gjasa që Kosova të krijojë shërbimin e saj zyrtar të inteligjencës. Rrjedhimisht, imponohet sfida e dyfishtë e bashkësisë ndërkombëtare dhe institucioneve të Kosovës: në njërin anë duhet që më në fund të shqyrtohet çështja e “shërbimeve të inteligjencës” që tanimë veprojnë dhe në anën tjetër duhet krijuar kushtet për një shërbim të vetëm të inteligjencës, të mbështetur në ligj, llogaridhënie dhe profesionalizëm. Në të kundërtën, edhe sikur të ketë “kosovarizim” përmbajtësor të institucioneve të sigurisë dhe bartje të përgjegjësive nga lëmitë e rezervuara nuk do të ketë përmirësime në sundim të ligjit përderisa ka struktura të cilat veprojnë pa mandat të qartë, pa kornizë ligjore, pa llogaridhënie dhe pa transparencë financiare. Prania e shërbimeve të këtilla, sipas të gjitha gjasave, do të jetë një nga sfidat më serioze për institucionet reja, të papërvojë dhe të brishta të sigurisë në Kosovë.<sup>6</sup>

## **SHPËRBËRJE APO LEGALIZIM?**

Ngritjen e çështjes së strukturave të tanishme në hije, të përkrahura nga partitë politike, e shoqëron një numër rreziqesh. Këto struktura mbesin të përkrahura edhe nga institucionet, ndonëse në mënyrë shumë më diskrete. Për më tepër, kur përballen me “rrezik të përbashkët” ka gjasa që strukturat e tilla të bashkojnë forcat kundër kërcënimeve të jashtme. Një Memorandum i Bashkëpunimit për të cilin pohohet se është nënshkruar ndërmjet IHSOP-it dhe SHIK-ut (2006) e vërteton këtë gatishmëri. Pavendosmëria e bashkësisë ndërkombëtare gjithashtu shkon në të mirë të strukturave të tanishme. Nga retorika e kohëpaskohshme kundër strukturave të tilla, dyshimet për bashkëpunim e deri tek deklaratat se “ato [strukturat në hije] në të vërtetë nuk janë joligjore, pasi nuk ka ligj që i shpallë ato si të tilla” (zyrtar i UNMIK-ut 2006), akterët ndërkombëtarë përgjegjës për sigurinë në Kosovë kanë demonstruar mungesë të seriozitetit në marrjen me këtë çështje. Tani, testi parësor qëndron në nxjerrjen e këtyre strukturave nga politika dhe shfrytëzimin, e asaj çfarë është e përdorshme si në aspektin e personelit ashtu edhe të pajisjeve, për krijimin dhe funksionimin e shërbimit të ardhëm të Kosovës.

---

<sup>6</sup> Mundësia që pjesëtarë të këtyre shërbimeve kanë depërtuar në organizatat e sigurisë dhe organizata të tjera (si TMK-ja) shtron një varg çështjesh rreth lojalitetit institucional, performancës, llogaridhënies dhe të ngjashme.

Prandaj, sfida qëndron në zgjedhjen ndërmjet shpërbërjes, transformimit apo ndoshta integritit të këtyre strukturave, apo në vazhdimin, si deri më tani, të qasjes së gabuar të tolerimit të tyre. Veprime të planifikuara mirë duhet të merren me ekzistencën e këtyre shërbimeve. Çështja që është injoruar deri më tani duhet të shtrohet për diskutim, të shqyrtohet dhe të zgjidhet si duhet.

Për këto dhe arsye të tjera, vazhdimi i tolerimit të shërbimeve në hije është i gabuar dhe i rrezikshëm. Siç tregojnë përvojat krahasimore, përballja me struktura të tilla në hije nuk lejon luksin e zvarritjes.

**Vazhdimi i tolerimit të shërbimeve në hije është i gabuar dhe i rrezikshëm.**

Tolerimi i pafund i organizatave të tilla dëmton sundimin e ligjit dhe seriozisht rrezikon zhvillimin e demokracisë. Kjo gjithashtu ushqen mosbesimin ndaj institucioneve të sigurisë dhe ngjallë frikë në mesin e qytetarëve për ndërhyrje arbitrare në privatësi dhe në të drejtat e tyre të tjera. Lirisht mund të nxirret përfundimi se kjo alternativë është tejte e mangët, ndonëse vazhdon të jetë e parapëlqyer nga administrata ndërkombëtare.

Përkrahja politike nga strukturat lokale dhe flirtimet e dyshuara me bashkësinë ndërkombëtare i shtojnë gjasat e rezistencës brenda strukturave në hije ndaj opsionit të shpërbërjes. Prania e këtyre strukturave bën të kuptojmë se ekzistojnë interesa të cilat ndërlidhen me veprimtaritë e tyre dhe vënia në pikëpyetje e atyre interesave shton gjasat e reagimeve negative. Rrjetet e gjëra të patronazheve zvogëlojnë në minimum gjasat e shpërbërjes së strukturave në fjalë. Përpjekja për t'i shpërbërë ato është gjithashtu e rrezikshme edhe për shkak të paaftësisë së institucioneve të zbatimit të ligjit për t'u marrë me probleme përmasash të këtilla. Për pasojë, është vështirë të imagjinohet se akterët ndërkombëtarë apo IPVQ-të do të avancojnë qëndrimet e tyre të gjertanishme dhe që, pa pasoja, të përballen me strukturat në hije.

**Të brengosur se struktura e re do të monopolizonte legjitimitetin e shërbimit inteligjent, përfaqësuesit e organizatave në hije pranojnë nevojën e futjes nën kontroll institucional dhe parapëlqejnë që të dalin nga funksionimi në vakuum.**

Pjesa më ironike e këtij opsioni qëndron në faktin se në rast se administrata ndërkombëtare vendos t'i shpërbëjë strukturat e tanishme, këto të fundit sipas të gjitha gjasave do të vazhdojnë të veprojnë qoftë në një mënyrë apo në një tjetër. Në një rast të tillë, organizatat në hije dhe patronët e tyre politikë do të ndjeheshin të tradhtuar nga bashkësia

ndërkombëtare pas viteve të "partneritetit në hije" me ta. Për pasojë, të njëjtit do të bënin gjithë çfarë është e mundur për të depërtuar në shërbimin e ardhshëm të inteligjencës, ose së paku do ia vështirësonin funksionimin atij.

Opsionet e kufizuara lënë alternativën e tretë, gjegjësisht vënien e kësaj çështjeje në tavolinë dhe integrimin e tyre në strukturën e re. Duke qenë kjo zgjidhja më optimale për ta, është e kuptueshme se disponimi brenda strukturave në hije intimisht shkon në favor të këtij opsioni. Të brengosur se struktura e re do të monopolizonte legjitimitetin e shërbimit inteligjent, përfaqësuesit e organizatave në hije pranojnë nevojën e futjes nën kontroll institucional dhe parapëlqejnë që të dalin nga funksionimi në vakuum. Zyrtarë të nivelit të lartë në këto shërbime bëjnë me dije se ekziston nevoja që të legalizohen dhe të veprojnë në një sistem ku "krahas kontrollit parlamentar si formë e detyrueshme, do të ushtroheshin edhe



forma të tjera kontrollit qeveritar” (zyrtar i SHIK-ut 2006).<sup>7</sup> E hartuar në formë të gërshetimit të stimulimeve dhe ndëshkimeve reale dhe në frymën e sundimit të ligjit, kjo alternativë do të mund të siguronte përkrahjen e partive politike, të institucioneve kryesore dhe të vetë pjesëtarëve të organizatave në hije.

## **NJË SHËRBIM I KOSOVËS**

Përderisa segmente të shumta të imazhit të ardhshëm institucional të Kosovës janë në shqyrtim e sipër është çështje kohe kur do të shtrohet çështja e krijimit të shërbimit të inteligjencës të Kosovës, meqë çdo vendi i duhet shërbimi i tillë. Mënyra në të cilën do i vie fundi ekzistencës së organizatave të tanishme është thelbësore për zhvillimin e strukturës së re e cila duhet të ndërtohet si duhet, mbi themele ligjore, me mandat të qartë dhe me vija të qarta të llogaridhënies. Në vijim janë paraqitur sfidat dhe mundësitë kryesore për këtë.

**Ka nevojë të madhe për të demistifikuar veprimtaritë e rregullta të shërbimeve të inteligjencës dhe të kuptohet se fokusi kryesor i tyre është mbledhja e të dhënave dhe analiza e tyre e jo operacionet e fshehta e përjashtimi nga ligjet të cilat vlejnë për shërbyesit civilë të tjerë.**

### **Sfidat**

Shërbimet inteligjente kryesisht shërbejnë për mbledhje dhe analizë të të dhënave dhe informatave relevante si dhe për kryerjen e veprimeve të kundërzbulimit. Me qëllim të kryerjes si duhet të këtyre veprimtarive, krahas mandatit të qartë dhe vijave të qarta të llogaridhënies, nevojiten edhe njerëz dhe burime të tjera. Për shkak të historisë së vonshme të Kosovës, shërbimet inteligjente kryesisht ngjallin ndjenja negative. Gjatë periudhës komuniste, okupimit të viteve nëntëdhjetë dhe deri në vendosjen e pranisë ndërkombëtare në Kosovë më 1999, shërbimet e inteligjencës ishin në ballë të përndjekjes së kundërshtarëve politikë. Mirëpo, shërbimi i inteligjencës nënkupton një numër të veçorive të ndryshme, si mbledhja e njohurive të caktuara, lloji i organizatës, veprimtaritë që ushtrohen nga ato organizatat, procesi përmes të cilit udhëhiqen aktivitetet e tilla dhe rezultatet të cilat rezultojnë nga aktivitetet dhe proceset në fjalë (DCAF 2006: 1).

#### *1. Politizimi*

Një ndër sfidat kryesore të shërbimeve të inteligjencës është gjetja e “baraspeshës së ndjeshme ndërmjet sigurimit të kontrollit të domosdoshëm demokratik mbi sektorin e sigurisë dhe parandalimit të manipulimit politik” (Leigh 2005: 6). Shumica e vëzhguesve të pavarur pajtohen me shqetësimet e shprehura nga zyrtarë të lartë të UNMIK-ut se strukturat e sigurisë në përgjithësi duhet të funksionojnë “në interesin e gjithë qytetarëve të Kosovës e jo vetëm në interes të partive politike” (Xharra 2005). Por, siç është parë tanimë me shumë segmente të tjera të shërbimit publik, tendenca për manipulim politik është i madh, veçanërisht në lëmitë e ndjeshme si ajo e sigurisë. Rreziku i politizimit ekziston, duke filluar nga çështja e mekanizmave të emërimit të shtresës më të lartë të zyrtarëve të

<sup>7</sup> Element i rëndësishëm i të dy strukturave është gatishmëria e tyre për t’i dorëzuar asetet kryesore shërbimit të ardhshëm e të ligjshëm. Megjithatë, përfaqësuesit e strukturave të njëjta shprehin rezerva rreth dorëzimit të dosjeve dhe dokumentacionit tjetër të tyre.

shërbimit të inteligjencës, kanaleve të llogaridhënies e deri tek procedurat e filtrimit të kandidatëve dhe një numër finesash të tjera. Për këtë arsye secili nga këta mekanizma duhet të krijohet me kujdes dhe me vëmendje të duhur kushtuar përvojave krahasimore.

## *2. Marrëdhëniet ndër-institucionale*

Shërbimet e inteligjencës nuk janë qëllim në vete dhe aktivitetet e tyre ndikojnë në vendimet e institucioneve të tjera dhe në formulim të politikave. Për vendimmarrje të mirë kërkohen të dhëna, vlerësime dhe paralajmërime nga shërbimet e inteligjencës. E marrë në izolim, inteligjenca e mirë nuk garanton politika të mira, por mungesa e saj garanton hiq më pak se dështim.

Nuk ka model të vetëm për mënyrën se si vendosen marrëdhëniet ndërmjet shërbimit të inteligjencës dhe institucioneve të tjera. Duke qenë të ndikuar nga faktorë të ndryshëm, dallojnë modelet e ndërveprimit institucional, ndonëse vërehen disa parime themelore të përbashkëta. Shërbimet e inteligjencës përherë duhet t'i nënshtrohen kontrollit qendror; të japin llogari para institucioneve më të larta civile (kryetarit, kryeministrit apo ministrave që nga ana tjetër japin llogari në parlament); të jenë të hapura për shqyrtim të brendshëm e të jashtëm dhe mbikëqyrje gjyqësore për t'u siguruar se nuk ka keqpërdorim të autorizimeve dhe se shërbimi nuk keqpërdoret nga qeveria; dhe duhet të mëtoj të jetë profesional e politikisht neutral (jopartiak).

Të dhënat tregojnë për rritje të konsensusit për krijim të shërbimit të inteligjencës jashtë ombrellës së ministrisë së brendshme. Një numër i deputetëve, politikëbërësve si dhe vetë IHSOP-i e SHIK-u pajtohen që shërbimi i ardhshëm duhet të jetë i ndarë nga ministria e brendshme (Xharra 2005). Vijat e llogaridhënies së këtij shërbimi duhet të jenë të vëna qartë kundrejt Kuvendit, Kryeministrit apo Kryetarit, apo ndonjë kombinimi të këtyre institucioneve. Disa nga udhëheqësit e këtyre strukturave duket se parapëlqejnë që kryeministri të jetë eprori i tyre drejtpërdrejtë (zyrtarë të SHIK-ut dhe IHSOP-it 2006). Përveç kësaj, qarkullojnë edhe ide për mekanizma të tjerë të kontrollit, si bie fjala vendosja brenda shërbimit e inspektorit të përgjithshëm (zyrtar i SHIK-ut 2006), sikundër edhe krijimin e Këshillit të Sigurisë Kombëtare (zyrtar i IHSOP-it 2006).

## *3. Korniza ligjore adekuate dhe e zbatueshme*

Krijimi i bazës së duhur ligjore në një vend ku tanimë veprojnë lirisht organizata në hije do të ishte një gjë e vështirë. Nuk është kohë e gjatë prej qe Kosova doli nga epoka e komunizmit, ku pothuajse nuk kishte fare standarde ligjore për funksionimin e strukturave të inteligjencës, ndërsa në rastet e rralla kur kishte standarde të tilla ndikimi i tyre ishte vetëm kozmetik. Kurse, "Shërbimet e

**Është shumë pak e mundshme që shërbimet aktuale të shndërrohen në shërbime të ligjshme dhe as që do të duhej të bëhej një gjë e tillë.**

inteligjencës gëzojnë legjitimitet vetëm kur pushteti i tyre i jashtëzakonshëm buron nga ligji" (DCAF 2006: 5). Ndonëse mund të ndryshojnë zgjidhjet praktike për të cilat mund të anojnë hartuesit e politikave dhe përpiluesit e ligjeve, ekzistojnë disa elemente që patjetër duhet të gëzojnë vëmendjen e ligjvënësit. Ligjet që shërbejnë si themel për funksionimin e shërbimeve të inteligjencës duhet që, së paku, të përcaktojnë hapësirat gjeografike brenda të cilave shtrihen përgjegjësitë e shërbimeve,

subjektet e hetimeve, kufijtë e përgjegjësive dhe kufizimet të cilat kanë të bëjnë me mënyrën e kryerjes së veprimtarive, marrëdhëniet ndërmjet shërbimeve të cilat i përkasin bashkësisë së inteligjencës dhe bashkërenditja e tyre, mënyrat e llogaridhënies (përfshirë mekanizmat e kontrollit ekzekutiv, mbikëqyrjen gjyqësore, mbikëqyrjen legjislative dhe mjetet ligjore për ankesa në rastet e shkeljes së të drejtave) (DCAF 2006: 5).

## **Epërsia e fillimit nga zeroja**

Krahas sfidave të shumta, gjendja aktuale gjithashtu ofron se paku një epërsi që nuk duhet humbur. Një ndër mundësitë kryesore në këtë mes qëndron në faktin se krijimi institucional i inteligjencës në Kosovë në një mënyrë fillon nga zeroja. Se a do të jetë fillimi krejtësisht nga zeroja varet edhe nga mënyra e adresimit të strukturave të tanishme. Megjithatë, është shumë pak e mundshme që shërbimet aktuale të shndërrohen në shërbime të ligjshme dhe as që duhet të bëhet një gjë e tillë. Në rastin më të mirë, personeli i tyre, në nivel individual, do të ketë mundësi për të konkurruar për pozitë brenda organizatës së re. Rrjedhimisht, mund të përfundohet se përkundër faktit që organizatat në hije tanimë pretendojnë të hyjnë në petkun ligjor, mungesa e një shërbimi të mirëfilltë të inteligjencës ofron mundësinë e krijimit ashtu siç duhet të këtyre institucioneve aq të ndjeshme.

## **PARIMET E NDËRTIMIT TË SHËRBIMIT TË ARDHSHËM TË INTELIGJENCËS NË KOSOVË**

Është përtej qëllimit të këtij punimi paraqitja e një modeli për strukturimin e shërbimit kosovar të inteligjencës, apo numërimi i të gjitha dispozitave që duhet t'i përmbajë baza ligjore që do e rregulloj këtë lëmi. Megjithatë, janë disa parime ligjore themelore të cilat imponohen nga standardet ndërkombëtare ndaj të cilave Kosova është e përkushtuar. Me përshtatje të nevojshme, parimet e mëposhtme duhet të jenë të pasqyruara në kornizën ligjore të shërbimit të ardhshëm. Është me rëndësi që të përmendet se disa nga këto parime dolën në shesh edhe gjatë diskutimeve me zyrtarë të lartë të "shërbimeve" të tanishme. Përveç kësaj, në të njëjtat diskutime u përmenden edhe parime të tjera si ai i "fuqizimit gradual" dhe i "multietnicitetit" (IHSOP 2006). Parimet e poshtëshënuara paraqesin kushtet minimale për funksionim si duhet të shërbimit të inteligjencës dhe duhet të jenë të çimentuara në kornizën ligjore për shërbimin e inteligjencës, krahas veçorive të tjera, të cilat, për shkak të natyrës së shkurtë të këtij punimi, janë lënë anash.

## **Krijimi i bazës ligjore**

Parakushti kryesor për ekzistencën dhe funksionimin e duhur të shërbimeve të inteligjencës është baza e duhur ligjore. Sa më të ndjeshme të jenë veprimtaritë të cilat duhet t'i kryejnë shërbyesit civilë aq më të forta arsyet për të vënë udhëzime të qarta për kryerjen e detyrave. Minimumi është përkufizimi i mandatit të shërbimit me qëllim të shmangies së keqpërdorimit të shërbimeve të inteligjencës kundër kundërshtarëve politikë të brendshëm dhe për shkelje të të drejtave të njeriut. Përveç kësaj, kur është në pyetje garantimi i ndalimit të vëzhgimit arbitrar apo ndërhyrjet e tjera në të drejtat e njeriut, korniza ligjore e shërbimeve të

inteligjencës duhet të pasqyrojë disa parime themelore, si ai që shërbimet mund të veprojnë vetëm në mbrojtje të interesit kombëtar, kur veprimet e tyre janë në përputhje me ligjet dhe të njëjtat janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike, krahas garantimit të mjeteve juridike në nivelin kombëtar (Cameron 2005: 38).

### **Kufizimi i përgjegjësive**

Ka nevojë të madhe për të demistifikuar veprimtaritë e rregullta të shërbimeve të inteligjencës dhe të kuptohet se fokusi kryesor i tyre është mbledhja e të dhënave dhe analiza e tyre e jo operacionet e fshehta e përjashtimi i zbatimit ndaj tyre të ligjeve të cilat vlejné për shërbyesit e tjerë civilë të tjerë. Është posaçërisht e rëndësishme që të kufizohen mundësitë e pajisjes së shërbimeve të inteligjencës me përgjegjësi ekzekutive. Çuditërisht, zyrtarë të lartë të të dy "shërbimeve" të tanishme nënvizojné nevojën që shërbimi i ardhshëm të jetë i kufizuar vetëm në hulumtime dhe analiza. Të njëjtit tërheqin vëmendjen në rreziqet që do të sillte dhënia e përgjegjësive ekzekutive shërbimeve të inteligjencës (zyrtarë të SHIK-ut dhe IHSOP-it 2006). Ata i nxjerrin këto sugjerime nga përvojat në Evropën lindore kudo që shërbimet inteligjente kanë pasur përgjegjësi ekzekutive.

### **Hartimi i mekanizmave të llogaridhënies**

Llogaridhënia si e tillë është koncept tejet i gjerë që, në njërin nga përkufizimet kushtetuese nënkupton "të qenit i thirrur për të dhënë llogari apo shpjegime për veprimet dhe, aty ku kjo është e përshtatshme, për të bartur pasojat, fajin apo ndërmarrjen e veprimeve drejt evitimit të pasojave nëse duket se janë shkaktuar pasoja" (Dawn 1991: 22). Siç është përmendur më lartë, një ndër vështirësitë kryesore në ndërtimin e një shërbimi të mirëfilltë e të efektshëm të inteligjencës është vënia e baraspeshës ndërmjet kornizës së domosdoshme për funksionim jopartiak dhe ruajtja e një kontrolli demokratik solid. Me fjalë të tjera, kjo vështirësi manifestohet si nevojë për të pasur agjencitë e inteligjencës "të shkëputura nga keqpërdorimi politik pa qenë të izoluar nga qeverisja ekzekutive" (Leigh 2005: 6). Kontrolli i buxhetit, mbikëqyrja parlamentare dhe kontrolli ekzekutiv janë parakushtet themelore për një shërbim llogaridhënës. Zyrtarë të lartë të "strukturave të inteligjencës" rekomandojnë krijim të komisionit parlamentar për inteligjencë si një mënyrë e mbikëqyrjes më të mirë (zyrtarë të SHIK-ut dhe IHSOP-it 2006). Përveç kësaj, zyrtarët në fjalë sugjerojnë që shërbimi i inteligjencës të jetë përgjegjës para Kryeministrit, e në një shkallë të caktuar, edhe para Kryetarit, me qëllim të shmangies së përqendrimit të tepërt të pushtetit në një institucion. Kanalet e llogaridhënies duhet të jenë të përcaktuara qartë në kornizën ligjore të shërbimit kosovar të inteligjencës si një parakusht për sundim të ligjit dhe mos-politizim të inteligjencës.

### **PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET**

Nuk ka dyshim se përpjekjet e UNMIK-ut për të zgjidhur çështjen e strukturave të tanishme pothuajse nuk kanë lëvizur përtej retorikës. Jo vetëm që shërbimet e tanishme janë toleruar deri më tani, por ka spekulime të shumta për flirtimin e

bashkësisë ndërkombëtare me shërbimet partiake. Ka munguar vullneti apo përkushtimi i organeve të pushtetit për të prirë me shembull, në kundërshtim me deklaratat e tilla si ajo se “të gjitha strukturat paralele [në Kosovë] do të shpërbëhen” (Greiçevci 2005: 5).

**Debate të hapura.** Është e domosdoshme që të shtrohet për diskutim çështja e strukturave të tanishme. Neglizhencës ndaj tyre dhe tolerimit të të njëjtave duhet t’i vije fundi. Zgjidhjet për çështje të tilla të ndjeshme duhet të vihen mbi themele të shëndosha para largimit të administratës ndërkombëtare.

**Kontrolli i buxhetit, mbikëqyrja parlamentare dhe kontrolli ekzekutiv janë parakushtet themelore për një shërbim llogaridhënës. Zyrtarë të lartë të “strukturave të inteligjencës” rekomandojnë krijim të komisionit parlamentar për inteligjencë si një mënyrë e mbikëqyrjes më të mirë**

**Mësimet e nxëna.** Organet e pushtetit duhet të ndërmarrin analiza të thella në mënyrë që të shmangen lëshimet dhe të arrihet një proces i shpejtë dhe i sigurt i themelimit dhe menaxhimit të institucioneve të inteligjencës.

**Proces transparent.** Kuvendi i Kosovës duhet që në mënyrë gjithëpërfshirëse të shqyrtoj procesin e krijimit të strukturës së inteligjencës dhe të inkurajoj dëgjime publike për këtë qëllim.

**Kushti i fillimit nga zeroja.** Pa e zgjidhur çështjen e strukturave të tanishme nuk mund të krijohet shërbimi i mirëfilltë i inteligjencës i cili do t’u përgjigjej nevojave të institucioneve të Kosovës dhe të gjithë kosovarëve. Përpjekjet për krijim të strukturës së re pa e zgjidhur çështjen e “strukturave në hije” nuk mund të kenë sukses dhe do të kufizoheshin vetëm në ndikim sipërfaqësor.

**Baza ligjore për një shërbim profesional.** Ekziston nevoja për të krijuar një shërbim të inteligjencës që ka mandatë të qartë dhe që mbështetet në themelet e ligjit e të transparencës. Për më tepër, duhet zhvilluar parimet ligjore të funksionimit të shërbimit të inteligjencës.

**Kontrolli demokratik.** Mekanizmat e llogaridhënies, kontrollit dhe të mbikëqyrjes duhet të krijohen dhe të respektohen. Është gjithashtu e nevojshme që të vendosen marrëdhëniet e duhura institucionale ndërmjet shërbimit të inteligjencës dhe organeve të tjera të sigurisë.

## REFERENCAT

- Cameron, Iain. “Beyond the Nation State: The Influence of the European Court of Human Rights on Intelligence Accountability” [“Përtej Shtetit-komb: Ndikimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Llogaridhënien e Shërbimeve të Inteligjencës, në librin “Who’s Watching the Spies?” [“Kush po i vëzhgon spiunët?”]. Born, Hans, Lock K. Johnson dhe Ian Leigh (redaktorë.).
- Daën, Oliver. (1991). Government in the United Kingdom: the search for accountability, effectiveness and citizenship. Philadelphia: [Qeverisja në

- Mbretërinë e Bashkuar: Në kërkim të llogaridhënies, efektshmërisë dhe shtetësisë Open University Press.
- DCAF. (Mars 2006) 'Shërbimet e Inteligjencës' (DCAF Backgrounder). 'Intelligence Services' [http://www.dcaf.ch/docs/bg\\_intelligence\\_services.pdf](http://www.dcaf.ch/docs/bg_intelligence_services.pdf) (vizituar: 20 prill 2006).
- Greiçevci, Bekim. (23 korrik 2005). "Jesen-Petersen: Të formohet Shërbimi Inteligjent i Kosovës kurse shërbimet paralele të shpërbëhen". "Zëri" Zyrtar i IHSOP-it. (28 shkurt 2006). Korrespondencë private. Prishtinë, Kosovë.
- Grupi Ndërkombëtar i Krizave, 'Kosova pas Haradinajt', [http://www.crisisgroup.org/library/documents/europe/balkans/163\\_kosovo\\_after\\_haradinaj.pdf](http://www.crisisgroup.org/library/documents/europe/balkans/163_kosovo_after_haradinaj.pdf) (ICG, 'Kosovo after Haradinajt')
- Leigh, Ian. (2005). 'More Closely Watching the Spies: Three Decades of Experience' ['Vëzhgimi më për të afërmi i Agjentëve: Tri Dekada të Përvojës', në librin "Who's Watching the Spies?" ["Kush po i vëzhgon spiunët?"] Hans Born, Lock K. Johnson dhe Ian Leigh (redaktorë.), Washington, D.C: Potomac Books.
- Security Sector Development Advisory Team (SSDAT) [Ekipi këshillëdhënës për zhvillimin e sektorit të sigurisë]. (2005). "Kosovo Internal Security Sector Review: Scoping Study." ["Shqyrtimi i Sektorit të Sigurisë në Kosovë"] [www.unmikonline.org/misc/ISSR\\_report.pdf](http://www.unmikonline.org/misc/ISSR_report.pdf) (vizituar 20 prill 2006).
- Zyrtar i SHIK-ut. (27 shkurt 2006). Korrespondencë private. Prishtinë, Kosovë.
- Zyrtar i UNMIK-ut. (2 shkurt 2006). Korrespondencë private. Prishtinë, Kosovë.
- Xharra, Jeta. (2005). "Kosovo's Intelligence Services Come In From The Cold" [Shërbimet e inteligjencës në Kosovë dalin nga të ftohtit"]. BIRN, [http://www.birn.eu.com/insight\\_15\\_6\\_eng.php](http://www.birn.eu.com/insight_15_6_eng.php) (vizituar: 27 dhjetor 2005).